

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje Automjet 6+1 për nevojat e Shoqërisë ”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Automjete 34100000-8

Vlera e fondit limit: 3.990.000 (tre milion e nentëqind e nentëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 përkatësisht në vlerën vlerën 79.800 (shtatëdhjetë e nente mijë e teteqind) lekë. (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006)“Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

e ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2025 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe te deklaruar ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar si kompani sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) **ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) **ISO 14001: Sistemi i Menaxhimit Mjedisor (ose ekuivalente)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi ISO 9001:2015 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilesive implementuese.

Certifikimi ISO 14001 (ose ekuivalente) është vendosur me qëllim garantimin që operatori ekonomik zbaton standarde të njohura ndërkombëtare për menaxhimin mjedisor, duke siguruar kontrollin e ndikimeve mjedisore që lidhen me aktivitetin e furnizimit, mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve. Ky standard garanton respektimin e legjislacionit mjedisor, menaxhimin e sigurt të mbetjeve teknike dhe reduktimin e rreziqeve mjedisore, duke kontribuar në realizimin e kontratës sipas parimeve të eficiencës, sigurisë dhe përgjegjshmërisë mjedisore."

2.3.3 Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë automjetin të regjistruar dhe të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim, përfshirë targat, lejen e qarkullimit dhe siguracionin e detyrueshëm TPL për vitin e parë të përdorimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar se operatori do të përmbushë kërkesat e AK

Argumentimi teknik

Kërkesa që operatori ekonomik fitues të dorëzojë automjetin të regjistruar dhe të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim, përfshirë targat, lejen e qarkullimit dhe siguracionin e detyrueshëm TPL për vitin e parë të përdorimit, është vendosur në funksion të vënies në përdorim të menjëhershëm të automjetit dhe garantimit të përmbushjes së të gjitha detyrimeve ligjore që lidhen me qarkullimin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka nevojë që automjeti i prokuruar të jetë plotësisht funksional dhe i gatshëm për përdorim menjëherë pas dorëzimit, pa qenë e nevojshme ndjekja e procedurave shtesë administrative për regjistrimin, pajisjen me targa apo sigurimin e detyrueshëm, të cilat mund të sjellin vonesa në përdorimin e tij dhe pengesa në realizimin e veprimtarisë institucionale.

Kjo kërkesë është e nevojshme pasi garanton që:

- Automjeti dorëzohet në gjendje të plotë operacionale dhe mund të përdoret menjëherë pas marrjes në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor;
- Janë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me regjistrimin dhe qarkullimin e automjetit;
- Shmangen vonesat administrative dhe kostot shtesë që mund të lindin gjatë procesit të regjistrimit dhe sigurimit të mjetit;
- Sigurohet mbulimi me siguracion të detyrueshëm TPL për vitin e parë të përdorimit, duke garantuar mbrojtjen e interesave të Autoritetit Kontraktor dhe të palëve të treta në rast aksidentesh apo dëmsh të shkaktuara gjatë qarkullimit;
- Garantohet transferimi i automjetit tek Autoriteti Kontraktor me dokumentacion të rregullt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për transportin rrugor dhe sigurimet e detyrueshme.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të sigurojë që automjeti të dorëzohet i kompletuar, i regjistruar dhe i gatshëm për përdorim të menjëhershëm, duke garantuar efikasitet në përdorimin e fondeve publike dhe përmbushjen pa ndërprerje të nevojave të Autoritetit Kontraktor

2.3.4 Automjeti i ofertuar duhet të përmbushë normat dhe standardet europiane në fuqi (CE) dhe të shoqërohet me Certifikatën e Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar se operatori do të përmbushë kërkesat e AK

Argumentimi teknik Kërkesa që automjeti i ofertuar të përmbushë normat dhe standardet europiane në fuqi (CE) dhe të shoqërohet me Certifikatën e Konformitetit European (Certificate of Conformity – COC), është vendosur në funksion të garantimit të cilësisë, sigurisë, performancës teknike dhe përputhshmërisë ligjore të automjetit që do të furnizohet.

Certifikata e Konformitetit European (COC) është dokumenti zyrtar i lëshuar nga prodhuesi i automjetit, i cili vërteton se automjeti është prodhuar dhe homologuar në përputhje me të gjitha direktivat dhe rregulloret europiane në fuqi për sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe parametrat teknikë të automjeteve.

Vendosja e këtij kriteri është e nevojshme pasi garanton që:

- Automjeti është prodhuar sipas standardeve të Bashkimit European dhe është i përshtatshëm për qarkullim në vendet europiane;
- Përmbush kërkesat ligjore dhe teknike për regjistrimin dhe pajisjen me dokumentacionin përkatës në Republikën e Shqipërisë;
- Respekton standardet europiane të sigurisë aktive dhe pasive, duke garantuar mbrojtjen e përdoruesve dhe të tretëve;
- Përmbush normat europiane për emetimet në mjedis dhe eficiencën energjetike;
- Siguron origjinën dhe autenticitetin e automjetit, duke shmangur furnizimin me mjete që nuk janë homologuar sipas standardeve europiane;
- Lehtëson procesin e regjistrimit, kolaudimit dhe administrimit të dokumentacionit teknik të automjetit.

Duke qenë se automjeti do të përdoret për nevojat operationale të Autoritetit Kontraktor dhe përbën një investim publik, paraqitja e Certifikatës së Konformitetit European (COC) përbën një garanci të domosdoshme që mjeti i ofertuar plotëson standardet teknike dhe ligjore të kërkuara, duke siguruar furnizimin me automjete cilësore, të sigurta dhe në përputhje me legjislacionin european dhe atë shqiptar në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të vlefshëm nga prodhuesi i automjeteve ose nga përfaqësuesi/distributori zyrtar i autorizuar për territorin përkatës, që vërteton të drejtën e furnizimit dhe mbështetjes teknike të automjeteve të ofertuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfutuesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion

lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të ketë në përdorim një servis të autorizuar dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e mjeteve rrugore, të vërtetuar me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë me Kod VII.3.B.1 ose ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar mbështetur në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 77, si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Kreu III, Seksioni II, Neni 41 pika 4, si dhe Nr. 9573, dt. 03/07/2006) “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar, si dhe natyrës së shërbimit të kërkuar.

Argumentimi teknik

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë ose të ketë në përdorim një servis të autorizuar dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e mjeteve rrugore, të vërtetuar me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë me Kod VII.3.B.1 ose ekuivalente, është vendosur në funksion të garantimit të mirëmbajtjes, servisit dhe mbështetjes teknike të automjeteve që do të furnizohen në kuadër të kontratës.

Automjetet objekt prokurimi përbëjnë mjete pune të rëndësishme për ushtrimin e aktivitetit të Autoritetit Kontraktor, ndaj funksionimi i tyre i pandërprerë dhe siguria teknike gjatë përdorimit janë elementë thelbësorë. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë kapacitetet e duhura teknike dhe profesionale për të garantuar ndërhyrje të specializuara, diagnostikim, riparime, mirëmbajtje periodike dhe trajtimin e defekteve të mundshme gjatë periudhës së garancisë.

Kërkesa për disponimin e një servisi të autorizuar dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi siguron që:

- Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të kryhen nga personel i kualifikuar dhe i licencuar;
- Të garantohen standardet e sigurisë teknike dhe rrugore të automjeteve;
- Të sigurohet disponueshmëria e pajisjeve dhe infrastrukturës së nevojshme për diagnostikimin dhe riparimin e mjeteve;
- Të reduktohen kohët e ndërprerjes së funksionimit të automjeteve dhe kostot që mund të lindin nga riparime të pasakta ose të paautorizuara;
- Të garantohet zbatimi korrekt i kushteve të garancisë së automjeteve dhe mbështetja teknike pas shitjes.

Disponimi i Certifikatës së Ushtrimit të Veprimtarisë me Kod VII.3.B.1 ose ekuivalente është një garanci minimale e nevojshme që operatori ekonomik zotëron kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale për të ofruar shërbimet e mirëmbajtjes dhe asistencës teknike të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës, duke mbrojtur interesin publik dhe investimin e Autoritetit Kontraktor.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nevojat funksionale dhe operationale të Autoritetit Kontraktor, me qëllim sigurimin e një automjeti të besueshëm, të sigurt, ekonomik në përdorim dhe të përshtatshëm për realizimin e detyrave institucionale.

Lloji i automjetit (SUV) është përcaktuar duke marrë në konsideratë nevojën për një mjet me kapacitet të lartë transporti, komoditet, siguri dhe aftësi lëvizjeje në kushte të ndryshme rrugore, si në zonat urbane ashtu edhe në ato periferike.

Viti i prodhimit 2023–2026 dhe kilometrazhi maksimal 80,000 km janë kërkuar për të garantuar furnizimin me një automjet bashkëkohor, me jetëgjatësi të lartë shërbimi, standarde të përditësuara sigurie dhe kosto të reduktuara mirëmbajtjeje.

Motori Diesel me cilindratë minimale 2100 cm³ dhe fuqi minimale 190 KF është kërkuar për të siguruar performancë të lartë, kapacitet të mjaftueshëm ngarkese dhe efikasitet gjatë përdorimit intensiv të automjetit. Konsumi maksimal prej 7.5 l/100 km synon optimizimin e kostove operative dhe përdorimin racional të karburantit.

Transmisioni automatik me minimum 8+1 marshe dhe sistemi i tërheqjes 4x4 garantojnë siguri, stabilitet, komoditet në drejtim dhe performancë optimale në kushte të ndryshme terreni dhe atmosferike.

Kapaciteti minimal 6+1 vende është përcaktuar për të përmbushur nevojat e transportit të personelit dhe për të garantuar fleksibilitet në përdorimin institucional të automjetit.

Pajisjet e sigurisë, si ABS, ESP, ASR, minimumi 6 airbag, sistemi inteligjent i parkimit dhe kontrolli automatik i ndriçimit, janë kërkuar për të garantuar mbrojtjen e drejtuesit dhe pasagjerëve, si dhe për të rritur sigurinë gjatë qarkullimit.

Pajisjet e komoditetit dhe teknologjisë, si klima automatike, sistemi i navigimit, Bluetooth, Cruise Control, sediljet me ngrohje dhe ftohje, pasqyrat elektrike, dritat LED dhe elementët e tjerë të kërkuar, janë të nevojshëm për të siguruar kushte optimale pune dhe përdorimi gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit të automjetit.

Pajisjet shtesë, si goma rezervë, kriu, kutia e ndihmës së shpejtë dhe aksesoret e tjerë standardë, janë të domosdoshme për garantimin e sigurisë dhe funksionalitetit të automjetit.

Garancia minimale 2-vjeçare ose 100,000 km, e mbështetur nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, është kërkuar për të mbrojtur investimin publik, për të garantuar cilësinë e automjetit dhe për të siguruar mbështetje teknike gjatë periudhës së përdorimit.

Shërbimet periodike të mirëmbajtjes çdo 10,000 km ose një herë në vit, si dhe përfshirja në çmim e regjistrimit, targave, lejes së qarkullimit dhe siguracionit TPL për vitin e parë, janë kërkuar për të garantuar që automjeti të dorëzohet i kompletuar, i gatshëm për përdorim të menjëhershëm dhe pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

Specifikimet teknike janë në funksion të realizimit me sukses të objektit të kontratës, garantimit të sigurisë, cilësisë dhe eficiencës ekonomike të investimit publik, duke respektuar parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit në prokurimin publik.

Njësia E Prokurimit: